

KALLËZIM PENAL

KALLZUES: PARTIA DEMOKRATIKE DEGA LUSHNJE

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale “Shpërdorim i detyrës”,
parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal, *Neni 328.*

KUNDER: [REDAKTUAR] i biri i [REDAKTUAR] i datëlindjes
[REDAKTUAR] lindur dhe banues ne Divjake, me detyrë
[REDAKTUAR]

DREJTUAR: PROKURORISE PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
LUSHNJE

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280, 283 të K.Pr.Penale, si dhe neneve 248 ,328 të Kodit Penal, parashtrajmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 parashikon se:

Neni 280

Marrja dajeni për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dajeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.